

Qendra për Demokratizim të
Shoqërisë Civile (QDSHC)

Center for Democratization
Civil Society (CDSC)

KOMUNA VUSHTRRI

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR FINANCIMI TË PËRBASHKËT

Palët nënshkruese të marrëveshjes,

- Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga,
z. Xhafer Tahiri, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)
 - Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile, Koralet, përfaqësuar nga
znj. Mysefa Terzici, Drejtoreshë (në tekstin e mëtejme Qendra)
-

Neni 1. Emërtimi i projektit

Korniza e përgjithshme për mbështetjen në programin e “Qendrave me Bazë në Komunitetit, bazuar në zhvillimin e fëmijërisë së hershme në zonat rurale ”

Neni 2. Qëllimi

Për arsye të një vargu të faktorëve shoqëroro-ekonomik, Komuna e Vushtrrisë dhe OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” e konsiderojnë të nevojshme mbështetjen institucionale dhe rritjen e gjithëpërfshirjes në nivelin e parë të sistemit të arsimit, edukimin parashkollor.

Komuna e Vushtrrisë, synon rritjen e gjithëpërfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor. Plani Zhvillimor i Arsimit në Komunën e Vushtrrisë synon që në bashkëpunim me OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” ta rritë përfshirjen e fëmijëve edhe në zonat rurale .

“Qendrat për Edukim të Hershëm me Bazë në Komunitet” kanë funksionuar që nga viti 2011 në fshatrat : Samarexhe, Lummadhe, Nadakovc, Vushtrri (shkolla Ali Kelmendi) dhe janë

financuar nga OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” me donatore UNICEF.

Neni 3.

Obligimet dhe përgjegjësitë e palëve të marrëveshjes

- 3.1 OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” për 15 muajt e ardhshëm prej 13.09.2021-13.12.2022 vazhdon financimin e tri qendrave me bazë në komunitet në: Stanocin e Epërm, në Stanocin e Poshtëm në SHML „ Migjeni” dhe në Vushtri në SHML “ Ali Kelmendi.
- 3.2 Komuna e Vushtrisë , prej 01.10.2021-13.12.2022 sipas kësaj marrëveshjeje, do të financon edhe dy qendra me bazë në komunitete në SHML “Hajrullah Shala” në Akashticë, dhe në SHML “Naim Frashëri” në Vushtri.
- 3.3 Komuna e Vushtrisë bënë rekrutimin e edukatoreve si dhe financon paga e tyre prej datës 01.10.2021-13.12.2022 , në formë subvencionimi, në vlerë prej 330 euro bruto ne muaj, po aq sa paguhen edhe edukatorët e qendrave që financohen nga OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” dhe UNICEF.
- 3.4 Kontratat e punës të edukatoreve i bart OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet”.
- 3.5 Komuna e Vushtrisë, bënë transferimin e buxhetit për paga të edukatoreve të të dy qendrave të reja në llogari të QDSHC „Koralet” në bankën **NLB Prishtina 17-07-001600020346.**
- 3.6 Komuna e Vushtrisë, për arsye të funksionalizimit dhe garancise së punës së edukatoreve obligohet që transferin e buxhetit për pagat e edukatoreve ta bëjë së paku çdo katër muaj.
- 3.7 OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” obligohet që sipas transfereve që e bënë komuna, ti bartë pagat tek edukatorët.
- 3.8 OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile „Koralet” nuk mbanë përgjegjësi për vonesat e pagave ose mos transferin e buxhetit të pagave nga komuna në llogarinë e saj.

Neni 4.

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje përfshinë periudhën: 13/09/2021 – 13/12/2022, sipas kontratës të nënshkruar me donatorin UNICEF.

Neni 5.

Zbatimi i marrëveshjes

Palët zotohen të respektojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e garantuara të njeriut, dhe zbatimin e politikave kundër ngacmimit dhe abuzimit në vendin e punës.

Neni 6.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin përmes konsultave me mirëkuptim të ndërsjellë.

Neni 7.
Hyrja në fuqi


Palët nënshkruese pajtohen që marrëveshje e mirëkuptimit të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Neni 8.
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër ekzemplarë, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Palët nënshkruese:

Drejtoresha e OJQ “Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile, Koralet”

1. Znj. Mysefa Terzici,  Datë 24. 09 2021
Adresa: Ramadan Kelmendi, Mitrovicë,
Kontakti: e-mail: qdshc.mitrovica@gmail.com,
Tel: 049 573 288



2. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Zt. Xhafer Tahiri  Datë, 24. 09 2021
Adresa: „Isa Boletini” nr 10
42000 Vushtrri
Kontakti: xhafer.sh.tahiri@rks-gov.net
Tel: 044308 852

